

# Stimulus për IHD dhe trajtimi i pabarabartë i investitorëve vendas në Maqedoni: Argumente dhe pasoja

## Propozim Korniza e Politikave Publike



### Vizioni

Politikat e IHD të optimizuara, në drejtim të interesave strategjik-ekonomik të Republikës së Maqedonisë, të bazuara mbi mbështetjen e rëndësishme të aksionarëve relevantë, duke i përfshirë, por të pakufizuar për komunitetin e biznesit, partnerët shoqërore dhe partitë politike.

### Objektivat dhe rezultatet

- Dëshmitë e reja, nga literatura relevante dhe nga praktika komparative, kontribuuan në drejtim të debatit të politikave për IHD në Republikën e Maqedonisë dhe të njëjtat janë shkëmbyer me faktorë relevantë.
- Debat i zgjeruar për stimulusit të IHD, në mënyrë që t'i përfshijnë analizat politike-ekonomike për realitetin e konkurrencës sa u përket IHD-ve ndërkombëtare midis shteteve.
- Të kuptuarit përkatës të motiveve dhe kontekstit të trajtimit të pabarabartë (diskriminimit) të investitorëve vendas.
- Marrja në konsideratë e pasojave të mundshme nga trajtimi i pabarabartë i investitorëve vendas.
- Pasqyrimi efektiv i barazisë së mirëfilltë, midis investitorëve vendas dhe të huaj, si instrument kyç për tejkalimin e ndjenjës së diskriminimit tek biznes komuniteti lokal.
- Zgjerimi i debatit lidhur me barazinë sa i përket përfshirjes së aspekteve gjithëpërfshirëse të drejtësisë sociale, veçanërisht balancimit midis kapacitetit fiskal të Qeverisë për ofertën e shërbimeve për qytetarët përkundrejt mbështetjes së kompanive multinacionale.
- Diskutim i filluar lidhur me politikat rajonale sa u përket sfidave dhe pasojave nga politikat nacionale për avancimin e IHD.

## Rezyme

Stimuluesit e lokacioneve, të cilat u ndahen investitorëve të huaj, janë çështja kryesore në debatin publik. Është e qartë se nëse nuk do të ekzistonte programi për stimulime të investitorëve të huaj, politikat e IHD do të ishin më pak të rëndësishme për publikun (ashtu siç ishte në periudhën para vitit 2006-2007) edhe pse do të ishte aktuale çështja për shpenzime tjera të lidhura (reklamimi ndërkombëtar, etj.). Interesi esencial i analizës ishte që t'i përgjigjet pyetjes se pse Qeveria maqedonase filloi me politika evidente të shtrenjta sa i përket ndarjes me zemërgjerësi të ndihmës shtetërore për investitorët e huaj. Konkluzioni, i cili rezultoi nga shqyrtimi i praktikave komparative, është se Qeveria, në njëfarë mënyre, ishte e detyruar ta bëjë këtë nga gara ndërkombëtare për IHD. Fakti i cili nuk diskutohet në debatin publik maqedonas është se vendi është përfshirë në një garë të ashpër ndërkombëtare për IHD. Kjo garë është veçanërisht e tensionuar në fushën e IHD me orientim eksportues, për të cilat lufton Maqedonia. Ekzistojnë prova të rëndësishme sa i përket shqyrtimit të praktikës komparative të prezantuar në literaturë për atë se vendet të cilat kanë vendosur t'i avancojnë IHD-të e brendshme dhe veçanërisht vendet me tregje të vegjël dhe me më pak resurse, nuk kanë alternativë tjetër, përveç se t'i pranojnë kushtet e garës së lokacionit. Një vend mund të zgjedh ose të kërkojë ose të mos kërkojë një lloj të dëshiruar të IHD (grinfield investime, investime me orientim eksportues). Megjithatë, nëse vendimi është që në mënyrë aktive të monitorohen IHD, atëherë vendi duhet t'i pranojë rregullat e garës për IHD. Është më se e qartë se për një vend si Maqedonia, stimuluesit e IHD janë pjesë kryesore e vendimeve të investitorëve që të vijnë dhe të investojnë. Nëse vendi vendos që t'i suspendojë stimuluesit, atëherë duhet ta pranojë faktin se prurjet e IHD në vend, të cilat çdoherë janë të vogla do të reduktohen në mënyrë plotësuese. Kjo është zgjedhja kryesore e politikës që duhet të merret në konsideratë. Duhet të theksohet se ky argument, për domosdoshmërinë e stimuluesve për IHD, nuk vërehet në debatin publik ku mesa duket qëndrim dominues është ai i mjedisit të mirë të biznesit si faktor kryesor për avancimin e IHD. Futja e këtij argumenti në debat (e që e nënkupton qëllimin ndaj të cilit synon të kontribuoj ky punim) në mënyrë relevante gjatë shqyrtimit të opsioneve politike. Opinioni kryesor është se a thua Maqedonia e vogël me kufizime fiskale, në mënyrë efektive mund të garojë në këtë garë me vende më të mëdha të cilat posedojnë resurse më të mëdha. Ky opinion duhet të matet në bazë të një analize rigoroze plotësuese. (Marrë në përgjithësi, deri më tani kishim vetëm një analizë të vogël të politikave qeveritare në lidhje me IHD, përveç asaj që është bërë nga gazetarët. Nevojiten më shumë analiza të këtilla). Në lidhje me këtë, paraqitet opinioni i këtillë: a ia vlen të përfundojë fushata pas përafërsisht një dekadë investime në të njëjtën? Për shembull, reduktimi a është opsion më i mirë? Është evidente se ekzistojnë rreziqe nga vendimi për përfshirjen në garën për IHD. Efekti evident negativ nga kjo garë përfshin kapacitet të reduktuar fiskal për ofrimin dhe dhënien e shërbimeve publike. Shtrohet pyetja nëse efektet nga IHD në vend i tejkalojnë shpenzimet e shkaktuara nga kapaciteti i reduktuar i këtillë fiskal. Dhe përsëri, kjo duhet të vendoset në bazë të matjeve të mëdha të përfitimeve përkundrejt shpenzimeve. Matja e këtillë duhet të jetë e gjatë. Çështja e diskriminimit të investitorëve vendas edhe më tutje mbetet pikë kritike për kontest dhe çështje politike polarizuese. Shqyrtimi i provave dëshmon se kjo çështje nuk është tipike për

Maqedoninë, por se është një dukuri e cila mund të shqyrtohet në vende tjera.

Provat vënë në dukje se kjo çështje ka potencial ta polarizojë agjendën politike nacionale dhe nga aktorët politikë të kërkojë të pozicionohen në raport me këtë çështje. Rasti maqedonas e ndjek këtë skemë.

Sondazhi i komunitetit të biznesit e vuri në dukje ndjenjën e ngjashme të trajtimit të pabarabartë. Pasojat e ndjenjës së trajtimit të pabarabartë të komunitetit të biznesit e përfshijnë dekurajimin e investitorëve vendas, rrjedhjen e kapitalit, si dhe të ashtuquajturën “round-tripping” (kapitali vendas i kamufluar në kapital të huaj që të mund të kualifikohet për stimuluesit). Kërcënimet nga investimet e dekurajuara vendase dhe rrjedhjet e kapitalit vendas (potencialisht në vendet fqinje të cilat ofrojnë stimulime) janë të vërteta.


Megjithatë, komuniteti i biznesit manifeston qëndrim për domosdoshmërinë e stimuluesve për IHD dhe ndjenjën se politikat qeveritare për avancimin e IHD tanimë fillojnë të japin rezultate.

Provat dëshmojnë se qeveritë mund ta kompensojnë ndjenjën e diskriminimit përmes pasqyrimin të prezantimit relevant të barazisë, i cili e tejkalon aplikimin retorik dhe normativ të ofrimit de jure të barazisë. Prezantimi efektiv i barazisë së mirëfilltë mesa duket është elementi kyç për kompensimin e ndjenjës së diskriminimit të cilën e kanë bizneset lokal.

Debati, në lidhje me pabarazinë në Maqedoni, është drejtpërdrejtë i fokusuar tek stimuluesit për investitorët e huaj përkundrejt subvencioneve për kompanitë vendase. Çështja e pabarazisë, në aspekt më të gjerë dhe antiglobal, në aspekt të mbështetjes së kompanive multinacionale në llogari të kapacitetit të reduktuar fiskal për ofrimin e shërbimeve për qytetarët (me theks të veçantë mbi të varfrit), mesa duket nuk është në interesin e drejtpërdrejtë për debat në Maqedoni. Ky argument meriton një zë më të lartë në debat.

Realiteti i garës për IHD u imponon qeverive zgjidhje të vështira. Siç mund të vërehet në literaturë, sfidat e këtilla nuk mund të zgjidhen në mënyrë efektive nga ana e qeverive nacionale dhe për të njëjtën nevojitet një koordinim ndërkombëtar. Aktualisht, në Maqedoni nuk zhvillohet një debat i këtillë (duke e pasur parasysh faktin se gara për IHD nuk është pranuar) dhe kërkimi i objektivit të këtillë, nga aspekti aktual, mesa duket është pak ambicioz. Megjithatë, fillimi i forumit rajonal për ta debatuar këtë çështje mund të jetë një hap i parë në këtë drejtim.

## Analizë e Faktorëve



## **Analiza PESTLE**

Mjedisit të jashtëm të IHD i është bërë një rezyme në formatin e analizës PESTLE, e cila i përfshin faktorët politikë, social, teknologjik, juridikë dhe etik.

### **Mjedisi politik**

Mjedisi i jashtëm i politikës së avancimit të IHD është polarizuar. Çështja, sa i përket trajtimit të pabarabartë të investitorëve vendas është relevante në agjendën politike. Protagonistët politikë pozicionohen në raport me këtë çështje. Politikat e IHD janë nën ndikimin e faktorëve të cilët e tejkalojnë kornizën nacionale të politikës.

### **Mjedisi ekonomik**

Maqedonia shënon rritje modeste ekonomike nga fundi i krizës globale ekonomike. Biznes komuniteti nacional ndihet i diskriminuar nga politikat qeveritare për IHD, megjithatë beson se deri më tani këto politika kanë gjeneruar efekte.

### **Mjedisi social**

Shkalla e papunësisë është midis shkallëve më të larta në Evropë. Standardi jetësor është në mesin e standardeve më të ulët në Evropë. Vendi ka sindikata të dobëta.

### **Faktorët teknologjik**

Importi i teknologjisë së re, përveç krijimit të vendeve të punës, është njëri nga motivet më të fuqishëm të politikave qeveritare për stimulimin e IHD. Çështja e rrjedhjes dhe integritetit të kompanive vendase në zinxhir me vlerë të krijuar nga IHD-të e brendshme është çështje me rëndësi kruciale, por e njëjta pamjaftueshëm është hulumtuar.

### **Faktorët juridikë**

Korniza e legjislacionit për avancimin e IHD, në masë të konsiderueshme është harmonizuar me legjislacionin evropian për ndihmë shtetërore. Roli monitorues i institucioneve kompetente, mesa duket, është i dobët.

### **Faktorët etikë**

Ekzistojnë prova nga praktika komparative për atë se konkurrenca për avancimin e IHD midis vendeve, gjatë disa dekadave të fundit, u shndërrua në një garë të tensionuar të “lokacionit”, me ç’rast stimuluesit e IHD janë instrumenti kryesor. Veç tjerash, kjo garë emërtohet edhe si “gara deri në fund” dhe “licitacioni”.

## Analiza e rreziqeve

Rreziqet kryesore përfshijnë:

- Kapacitet të reduktuar fiskal për ofrimin e shërbimeve publike, i cili fillimisht ndikon mbi të varfrit
- Rritja e borxhit publik
- Varësi e madhe nga stimuluesit për IHD, si mekanizëm për parandalimin e largimit të investitorëve dhe humbjen e vendeve të punës
- Investime vendase të dekurajuara
- Rrjedhja e kapitalit vendas
- Gara deri në fund; masa për zgjidhjen e problemeve në llogari të përkeqësimit të problemeve ekonomike të vendeve tjera (“evermorecostlybeggar-thy-neighbor-measures”).

## Rruga drejt

- Fillimi i debatit me oponentët politikë dhe përfaqësuesit e biznesit për domosdoshmërinë e stimuluesve për IHD, të bazuar mbi transparencë të rritur.
- Vendosja e mekanizmave të fuqishëm për matjen e efektit të stimuluesve për IHD; sigurimi i hapësirës për qëndrime të ndryshme dhe transparencë të rezultateve të matura.
- Krijimi i kushteve për manifestimin efektiv të barazisë së mirëfilltë (jo vetëm de jure) për investitorët vendas sa u përket stimuluesve për investime.
- Zgjerimi i debatit në lidhje me pabarazinë dhe mbi boshtin e drejtpërdrejtë të barazisë së investitorëve, me qëllim t’u përgjigjen pyetjeve në lidhje me drejtësinë sociale gjithëpërfshirëse; sigurim të përfshirjes më të thellë të shoqërisë civile në këtë debat.
- Iniciativa për krijimin e forumit rajonal për diskutimin e politikave stimuluese të IHD dhe mekanizmave për kontrollin e tyre.

## **Ndikimet kryesore**

- Dialog i përmirësuar politik dhe social në lidhje me domosdoshmërinë e politikave për stimulimin e IHD.
- Ndjenjë e zvogëluar e trajtimit të pabarabartë të biznes komuniteti nacional.

## **Matja**

- Matje sistematike, e gjatë dhe transparente të efekteve nga politikat e vendit për promovimin e IHD.
- Sondazhe të rregullta për opinionin publik.
- Sondazhe periodike të biznes komunitetit.